



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 31/Prot.
16

Tiranë, më 07.10.2022

V E N D I M

Nr. 124, datë 07. 10. 2022

PËR PUSHIMIN E PROÇEDIMIT DISIPLINOR

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore Bujar Arapi, dëgjoi pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, “Për procedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Bujar Arapi”, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore me numër protokollit 31, datë 12.07.2022, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.78, datë 21.07.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Bujar Arapi”, për kryerjen e shkeljeve disiplinore, “Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasojë për hetimin e çështjes”, të nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërma “ç”, e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit Andi Pogaçe dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të ligjit nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Bujar Arapi, gjatë hetimit të procedimit penal nr.1370, regjistruar në datën 12.10.2021, për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” (në gjendje të dehur, ose nën efektin e lëndëve narkotike), parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Nga aktet që u administruan gjatë seancës dëgjimore për procedimin disiplinor, rezultojn se:

2.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në datën 12.12.2021 ka regjistruar procedimin penal Nr. 1370, të vitit 2021 për figurën e veprës penale “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, në gjendje të dehur, ose nën efektin e lëndëve narkotike, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Për hetimin e këtij procedimi penal është ngarkuar oficeri i Policisë Gjyqësore i Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Bujar Arapi, i cili, ka referuar edhe materialin kallëzues në prokurori.

2.2 Nga aktet e procedimit penal rezultojn se në datën 10.12.2021, në aksin rrugor Patos – Margëlliç, drejtuesi i automjetit të markës “BMV”, me targa AA 600 OU, Fabio Ferataj ka humbur kontrollin e automjetit dhe është përplasur me një automjet tjetër të llojit autobus me targa AA 951 XT, që drejtohej nga shtetasi Jetnor Asllanaj, duke dalë nga rruga dhe përfunduar në brendësi të lagjes “Margëlliç”.

Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Bujar Arapi, pasi janë kryer veprimet e para hetimore, në datën 11.12.2021, materialet janë referuar për vlerësim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

Sipas informacionit për referimin e veprës penale, të oficerit të Policisë Gjyqësore Bujar Arapi, shtetasit Fabio Ferataj, i është bërë testi i alkolit nëpërmjet aparatit të testimit të alkolit. Nga kryerja e këtij veprimi ka rezultuar se shtetasi Fabio Ferataj kishte konsumuar alkol. Nga matja e parë ka rezultuar niveli i alkolit prej 0.61 mg/l, nga matja e dytë, 0.48 mg/l dhe nga matja e tretë 0.72 mg/l alkol.

Në datën 10.12.2022, shtetasit Fabio Ferataj, i është marrë mostra e gjakut për kryerjen e ekspertimit toksikologjik nga Instituti i Mjekësisë Ligjore. Mostra e gjakut rezultojn se është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore brenda datës 13.10.2021.

2.3 Në vijim të hetimeve, është administruar Akti Ekspertimit Toksikologjik, 13 datë 31.12.2021, i Institutit të Mjekësisë Ligjore. Në aktin e ekspertimit toksikologjik, eksperti ka konkluduar se “*Mostra e gjakut në tub me xhel është plotësisht e koageluar dhe nuk mund të analizohet. PËRFUNDIM: Duke u mbështetur në rezultatet e analizave të fituara arrijmë në përfundimin: 1. Mostra e gjakut marrë shtetasit Fabio Ferataj është plotësisht e koageluar dhe nuk mund të analizohet. Mostra duhet të ishte vendosur në tub me antikoagulantë.*”

- Ndodhur para kësaj rrethane, është pyetur infermieri i Spitalit Rajonal Fier, Aurel Tanaka i cili ka deklaruar se është infermier pranë këtij spitali dhe prej një viti punon në repartin e urgjencës. Oficerin e policisë gjyqësore Bujar Arapi e njoh prej një viti, kur e ka takuar në muajin dhjetor 2021 lidhur me marrjen e një mostre gjaku nga një person të cilin nuk e njohte. Ai ka deklaruar se janë paraqitur në spital dy punonjës policie bashkë me një shtetas që dukej në gjendje të dehur dhe kundërshtues. Punonjësit e policisë i kanë kërkuar që këtij personi t'i merret mostrën e gjakut. Shtetasi Aurel Tanaka ka pyetur dy punonjësit e policisë se çfarë duhet të kryente dhe më pas i ka marrë kampionin e gjakut shtetasit Fabio Ferataj. Më pas ai ka shkuar në Komisariatin e Policisë Fier dhe i ka dorëzuar mostrën e gjakut oficerit të policisë gjyqësore Bujar Arapi, i cili më pas ka firmosur dhe procesverbalin e marrjes së mostrës së gjakut. Shtetasi Aurel Tanaka ka shpjeguar se ky është rasti i parë dhe i vetëm ku policia i ka kërkuar të marrë mostër gjaku.

- Është pyetur oficeri i policisë gjyqësore Bujar Arapi, i cili ka shpjeguar se nuk është specialist i kësaj pune dhe se kjo është detyrë e doktorëve dhe infermierëve. Ai deklaroi se ka qenë në Komisarlatin e Policisë kur është marrë mostra e gjakut dhe infermieri ia ka sjellë atë aty dhe ai ka nënshkruar dhe proçeverbalin përkatës.

- Në vijim të hetimeve, është pyetur shtetasja Zana Bruçi, me detyrë eksperte toksikologjike pranë IML, e cila ka kryer ekspertimin dhe ka përpiluar aktin e ekspertimit toksikologjik. Shtetasja Zana Bruçi ka deklaruar se Drejtorive Vendore të Policisë u është dërguar disa herë procedura standarte e marrjes së mostrave biologjike dhe ata janë njohur me këtë proçedurë dhe për këtë arsye mostra e gjakut nuk vendoset në tub me xhel pasi mostra e gjakut duhet të jetë e lëngshme dhe jo e koaguluar. “*Sqaroj – shpjegon shtetasja Zana Bruçi - se ngjyra e tubit të epruvetës nuk është ajo që përcakton marrjen e analizës por lënda e shtuar gjatë prodhimit dhe shënuar në etiketën e tubit. Në rastin konkret nuk është detyrë e OPGJ që të informoj personelin mjekësor se në çfarë lloj tubi duhet të vendoset mostra e gjakut për analizën e alkolit. Këto janë proçedura standarte*”.

2.4 Në kërkesën e Prokurorit Andi Pogaçe, parashtrahet se gjatë hetimit të proçedimit penal, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Bujar Arapi janë kryer disa shkelje flagrante ligjore dhe proçedurjale sikurse janë :

a) Oficeri i Policisë Gjyqësore Bujar Arapi ka vepruar në kundërshtim me proçedurat standarte të punës që IML i ka dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Fier me shkresën nr.1340 prot., datë 03.09.2015. Kjo sjellje e këtij oficeri të policisë gjyqësore është e përsëritur pasi dhe më parë është referuar për një shkelje të tillë disiplinore, por nuk është marrë masë ndaj tij sepse është pretenduar kalimi i afatit për fillimin e proçedimit disiplinor.

b) Rezulton se proçesverbali i marrjes së mostrës së gjakut nuk pasqyron fakte e rrethana që i përgjigjen të vërtetës objektive. Oficeri i Policisë Gjyqësore që duhet të hartonte aktin dhe të ishte prezent gjatë marrjes së mostrës së gjaku, në fakt nuk ka qenë fare i pranishëm, por priste në Komisarlatin e Policisë Fier. Si pasojë e mosrespektimit të kësaj proçedure, mostra e gjakut është administruar në mënyrë të gabuar dhe me efekte të pariparueshme. Si rrjedhojë e kësaj shkelje nuk është bërë e mundur të evidentohet fakti nëse i dyshuari kishte konsumuar lëndë narkotike apo jo, si dhe nuk mund të përcaktohet saktë dhe në mënyrë shkencore niveli i alkolit në gjakun e këtij shtetasi në momentin e ndodhjes së ngjarjes.

c) Oficeri i Policisë Gjyqësore Bujar Arapi ka hartuar dhe nënshkruar akte proçedurjale që pasqyrojnë veprime hetimore në të cilat nuk ka qenë i pranishëm në momentin e kryerjes së tyre.

2.5 Këto veprime dhe shkelje të kërkesave ligjore dhe proçedurjale, të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Bujar Arapi, nga ana e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, konsiderohen si shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërma “ç”, ndaj kërkon dhënien ndaj tij të një nga masave disiplinore, të parashikuara nga neni 34, pika 4 e ligjit të sipërcituar, largim nga detyra.

3. Komisioni i Policisë Gjyqësore, në funksion të një procesi të rregullt dhe të plotë ligjor, me qëllim sqarimin e plotë të shkeljeve disiplinore dhe rrethanave në të cilat janë kryer ato, të parashtruara nga Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në kërkesën propozim për fillimin e procedimit disiplinor nda oficerit të Policisë Gjyqësore Bujar Arapi, administroi aktet nga procedimi penal nr.1370, regjistruar në datën 12.10.2021, bashkalidhur kërkesës së Prokurorit Andi Pogaçe, dëgjoi shpjegimet e subjektit të proceduar Bujar Arapi, dëgjoi shpjegimet e punonjësit të Policisë Ermal Saliasi, i thirur si dëshmitar nga subjekti Bujar Arapi dhe administroi të dhënat nga dosja personale e oficerit të policisë gjyqësore Bujar Arapi Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor, analiza e tyre, shpjegimet e vetë subjektit të procedimit disiplinor, rezultoi se:

3.1 Lidhur me shkeljen ligjore të parashtruar në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinore, se oficeri i policisë gjyqësore Bujar Arapi ka vepruar në kundërshtim me procedurat standarte të punës që IML i ka dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Fier me shkresën nr.1340 prot., datë 03.09.2015, nuk u vërtetua që kjo shkelje të jetë kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Bujar Arapi. Sikurse rezulton nga akti i ekspertimit toksikologjik, mostra e gjakut e dërguar për ekspertim, ka humbur cilësitë e tij, për shkak se nuk është marrë në epruvetën e caktuar për këtë qëllim dhe për pasojë ajo nuk mund të analizohet nga mjeku ligjor. Por, për këtë shkelje të standarteve të punës, nuk mund të ngarkohet oficeri i policisë gjyqësore Bujar Arapi. Mostra e gjakut është marrë në ambientet e spitalit Fier nga infermieri i këtij spitali, Aurel Tanaka, i cili ka dhe përgjegjësinë për kryerjen e këtij veprimi.

Sikurse ka deklaruar ekspertja toksikologe praë IML, Zana Bruci, e pyetur organi i prokurorisë gjatë hetimit të procedimit penal, *ngjyra e tubit të epruvetës nuk është ajo që përcakton marrjen e analizës por lënda e shtuar gjatë prodhimit dhe shënuar në etiketën e tubit. Në rastin konkret nuk është detyrë e OPGJ që të informoj personelin mjekësor se në çfarë lloj tubi duhet të vendoset mostra e gjakut për analizën e alkolit. Këto janë procedura standarte.*”

3.2 Komisioni nuk i gjen të bazuar as parashtrimet e bëra në propozimin për fillimin e procedimit disiplinor se “procesverbali i marrjes së mostrës së gjakut nuk pasqyron fakte e rrethana që i përgjigjen të vërtetës objektive. Oficeri i Policisë Gjyqësore që duhet të hartonte aktin dhe të ishte prezent gjatë marrjes së mostrës së gjaku, në fakt nuk ka qenë fare i pranishëm, por priste në Komisariatin e Policisë Fier” dhe se “Si pasojë e mosrespektimit të kësaj procedure, mostra e gjakut është administruar në mënyrë të gabuar dhe me efekte të pariparueshme”. Gjithashtu nuk gjen të bazuar dhe parashtrimin si shkelje disiplinore, i faktit se “Oficeri i Policisë Gjyqësore Bujar Arapi ka hartuar dhe nënshkruar akte procedurjale që pasqyrojnë veprime hetimore në të cilat nuk ka qenë i pranishëm në momentin e kryerjes së tyre”

Procesverbali për marrjen e mostres për ekspertim, datë 10.12.2021 përshkruan pikërisht këtë veprim, marrjen e mostrës së gjakut shtetasit Fabio Ferataj nga infermieri i spitalit Fier Aurel Tanaka, në prani të dy punonjësve të policisë Elidon Zoto dhe Ermal Saliasi, me porosi të oficerit të policisë gjyqësore Bujar Arapi. Ky procesverbal është nënshkruar nga të tre personat që kanë gjatë marrjes së mostrës.

Lidhur me marrjen e mostrës së gjakut, subjekti i proceduar disiplinorisht, shpjegoi në seancë dëgjimore se “ditën që ka qenë me shërbim në kontrollin e linjës Levan-Tepelenë, kur e kanë njoftuar se kishte ndodhur një aksident tjetër në një fshat të Patosit, dhe meqëse ishte larg ka

dërguar patrullën e policisë Patosit për të shkuar në vendin e ngjarjes dhe një patrullë tjetër të Fierit e ka dërguar në spital për të parë të plagosurit. Patrulla e policisë i ka bërë testin e alkolit drejtuesit të mjetit i cili ka rezultuar se kishte konsumuar. Meqëse isha larg dhe mund të vonohesha - shpjegoi oficeri Bujar Arapi - i kërkova patrullës që ti merrnin mostrën e gjakut drejtuesit të mjetit. Kur u ktheva, patrulla e policisë e kishte marrë kampionin e gjakut. Unë u thashë të merrenin dhe infermierin, dhe të vinin që të firmosim procesverbalin dhe të kryenim të gjitha procedurat dhe ashtu u bë. Sapo u dorëzua mostra, bëra procesverbalin e marrjes mostrës se gjakut që ishte marrë në spital nga patrulla policisë dhe procesverbali u firmos nga Elidon Zoto, Ermal Saliasi dhe është firmosur nga ana ime dhe e infermierit”.

Këto shpjegime të tij, gjetën mbështetje nga shpjegimet e dëshmitarir Ermal Saliasi, I pyetur nga Komisioni mbi kërkesën e subjektit të proceduar Bujar Arapi. Punonjësi i policisë Ermal Saliasi shpjegoi se: *“Ditën e ngjarjes kemi qene patrulle patrulle qyteti, patrulla e linjes. Jemi thirrur me urdher te 86-2(Bujar Arapit) dhe me urdher te tij kemi levizur nga qyteti ne drejtim te Patosit sepse patrulla tjeter ishte ne vendngjarje. Kemi shkuar tek qendra shendetesore e Patosit, ku kemi marre kontakt me drejtuesin e mjetit per ti bere testin e alkolit drejtuesit te mjetit, i cili nuk ishte ne gjendje te mire shendetesore .Jane bere matjet me aparat dragger dhe matja e pare ka rezultuar 0.6 qe do te thote drejtuesi i mjetit ka qene me sasi te lart alkoli dhe ishte per ndalim, eshte bere matja e dyte dhe ka rezultuar 0.49 dhe ne ate moment oficeri Bujar Arapi ka ardhur aty ne qendren shendetesore sepse ate dite ka pasur shume aksidente ne mos gaboj 2-3 vendgjarje. Drejtuesi i mjetit beri kerkese tek drejtuesit e spitalit te Patosit per kontroll me te specializuar, ne spitalin e Fierit dhe u bë kalimi nga spitali i Patosit per ne spitalin e Fierit. Ne spitalin e Fierit eshte bere dhe marrja e mostres se gjakut drejtuesit te mjetit, me urdher te oficerit Bujar Arapi dhe prokurorit*

Drejtuesin e mjetit e shoqeruar për në spitalin e Fierit me ambulance unë dhe kolegu Elidon Zoto,.

Mostra e gjakut u mor me urdhër të oficerit Bujar Arapi.

Oficeri Bujar Arapi ka ardhur ne qendren shendetesore të Patosit, nga vendngjarja ne te cilen ishte. Duke qene se dy matjet e para ,me aparat drager te nivelit te alkolit kishin luhatej Bujar Arapi ka kerkuar ti behet dhe nje test i trete, dhe ne prani te tij eshte bere matje e trete ku rezultoi se drejtuesi i mjetit kishte nivel te larte te alkolit ne gjak dhe duhej te ndalohej. Nga ai moment Bujar Arapi na ka urdheruar qe te shoqerojme drejtuesin e mjetit ne spitalin e Fierit qe te kryhen ekzaminimet e specializuara shendetesore si dhe procedura e marrjes se mostres se gjakut.

Pastaj me infermierin, te shoqeruarin kemi shkuar ne Komisariatin e Fierit Procesverbali u firmos nga ne oficeri i policise gjyqesore Bujari Arapi dhe Infermieri”.

Nga këto shpjegime dhe provat e tjera që u administruan, nuk rezulton asnjë indicie apo e dhënë për të vënë në dyshim vërtetësinë e të dhëna dhe veprimet të kryer, të pasqyruar në procesverbalin e marrjes së mostrës për ekspertim, datë 10.12.2021. Nuk rezulton që në procesverbal të jetë pasqyruar ndonjë e dhënë apo rrethanë që nuk i përgjigjet së vërtetës, lidhur me veprimin hetimor të kryer, marrja e mostrës së gjakut.. Vendi i nëshkrimit të aktit nga oficeri i policisë gjyqësore Bujar Arapi, nëse është nënshkruar në spital, ku u mor mostra e gjakut apo në komisariat, nuk ka asnjë rëndësi për vlefshmërinë e proves.

Për aktet procedurale të cilat pasqyrojnë veprimet hetimore, ka rëndësi vërtetësia e faktit që ato pasqyrohet në akt apo dokument, nuk ka rëndësi vendi ku hartohet dhe nënshkryet ky akt, në vendngjarje apo në zyrë.

I pambështetur është konstatimi i prokurorit Andi Pogaçe se “si pasojë e mosrespektimit të kësaj procedure, (mungesa e pranisë së oficerit Bujar Arapi në momentin e marrjes së mostrës së gjakut) mostra e gjakut është administruar në mënyrë të gabuar dhe me efekte të pariparueshme”.

Një konkluzion i tillë nuk është mbështetur me asnjë provë apo argument që provon se prania e oficerit të policisë gjyqësore Bujar Arapi në marrjen e mostrës, do parandalonte marrjen e gjakut nga infermeri me epruvetën e gabuar.

5. Në përfundim, në analizë dhe vlerësim të akteve të administruar gjatë shqyrtimit të procesit disiplinor, përfshirë dhe sqarimet dhe shpjegimet e subjektit të procedimit disiplinor, Komisioni i Policisë Gjyqësore, arrin në përfundimin se shkeljet disiplinore të parashtruara si të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Bujar Arapi, nuk qëndrojnë.

Në rastet kur shkeljet disiplinore nuk provohen ose nuk qëndrojnë, referuar nenit 38 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” dhe nenit 13 të Rregullores nr.10, datë 21.04.2020 “Për procedimin disiplinor”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, Komisioni duhet të pushojë procedimin disiplinor.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”, 11, pika 4 dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me 4 vota pro.

V E N D O S I:

1. Pushimin e procedimit disiplinor ndaj Oficerit të Policisë Gjyqësore Bujar Arapi, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier.
2. Me këtë vendim, të njihet oficeri i policisë gjyqësore Bujar Arapi.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

ARJAN MUÇAJ

ANËTAR

HARI GOGO

mungon

ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇA

[Signature]